



Prishtinë: 20.08.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1025_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1819_06_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **01.08.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 20.08.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin M.K. nga fshati Llukar i Prishtinës me shifër të konsumatorit: DPR - 64847, si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1819_06_18 i datës 22.06.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04.06.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: DMK/ZRRE nuk e ka vlerësuar drejtë që të obligojë KESCO-n që të bëjë anulimin e korrigjimit datës 28.08.2017 në vlerë prej 834.01€ dhe shpërndarjen e shpenzimit për periudhën 09/2014 – 09/2014. Gjithashtu në ankesë është theksuar se vendimi i DMK/ZRRE për shpërndarjen e kWh nga 09/2010 deri më 09/2014 anulon disa lexime 09, 10, 11/210 dhe 01, 05, 07, 10/2011 dhe nuk merr parasysh që këto lexime kanë qenë të sakta dhe se gjendja e kWh të konstatuar në periudhën 09/2014 nuk kthehen më tepër se periudha 11/2011 dhe shpërndarja e kWh në periudhë më të gjatë nuk paraqet shpërndarje reale. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1819_06_18 të datës 22.06.2018. për konsumatorin M.K. me shifër DPR - 64847.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se DMK/ZRRE nuk e ka vlerësuar drejtë që të obligojë KESCO-n që të bëjë anulimin e korrigjimit datës 28.08.2017 në vlerë prej 834.01€, Bordi i ZRRE thekson se kjo nuk



qëndron pasi që sipas analizave të bëra shkresave të lëndës konsumatori nuk ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr. 08196246 nga fillimi deri në periudhën 09/2014 dhe kjo vërtetohet edhe nga korigjimi i bërë nga vet KESCO. Bordi i ZRRE-së thekson se sipas dispozitave ligjore të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurës për Lexim dhe Faturim, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i obliguar të bëjë lexim të rregullt mujor të konsumatorëve, gjë që te konsumatori në fjalë nuk ka ndodhur.

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike respektivisht shpenzimin e konsumatorit për periudhat e mëvonshme me njehsorin elektrik nr.08196246: periudha 02/2015 është **467 kWh**, periudha 05/2015 është **585 kWh**, periudha 02/2016 është **407 kWh**, periudha 05/2016 është **530 kWh**, periudha 02/2017 është **392 kWh**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.32602917 periudha 02/2018 është **338 kWh**, si dhe periudha 05/2018 është **381 kWh**. Bazuar në analizat e bëra vërtetohet se faturimi i periudhës shkurt dhe maj 2014 nuk përputhet me shpenzimet reale mujore të konsumatorit.

Sa i përket pikës së kundërshtimit vendimi i DMK/ZRRE për shpërndarjen e kWh nga 09/2010 deri më 09/2014 anulon disa lexime 09, 10, 11/2010 dhe 01, 05, 07, 10/2011, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron pasi që në muajt para këtyre periudhave kemi lexim dhe faturim në të dy tarifatat, ndërsa në periudhat 09/2010 dhe 10/2010 kemi lexim dhe faturim vetëm me një tarifë, pastaj në periudhën 11/2010 lexim dhe faturim në të dy tarifatat, dhe për periudhat tjera pas kësaj herë kemi lexim dhe faturim në një tarifë dhe herë kemi lexim dhe faturim në të dy tarifatat. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së konstaton se te rasti i konsumatori nuk kemi lexim dhe faturim të rregullt të pikës matëse. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka analizuar korigjimin e faturave për periudhën 11/2011 deri në periudhën 08/2014 në vlerë **-834.01€ të bërë nga KESCO** dhe konstaton se KESCO ka gabuar pasi që konsumatorit duhet t'i bëhet korigjimi i faturave nga periudha 09/2010 deri në periudhën 09/2014 në vlerë **-932.62 €**, dh se për diferencën e mbetur prej 564.64€ t'i ofrohet kontrata për pagesë për periudhën 24 mujore.

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës, respektivisht të procesverbalit të kalibrimit ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin nr.08196246 dhe kanë konstatuar se njehsori nuk është në rregull, si dhe gabimi në matje është **-0.39%**, si dhe kanë evidentuar si vërejtje që njehsori elektrik është pa bllombë të ndarësit të tensioneve. Bordi i ZRRE-së thekson se KEDS nuk ka dhënë asnjë sqarim me shkrim lidhur me këtë vërejtje se pse njehsori është pa bllombë të ndarësit të tensioneve, kur dihet se sipas nenit 54 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pronar i pikës matëse dhe se për çdo muaj bënë leximin dhe faturimin e pikës matëse.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nixirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit M.K. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.